



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/02/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga I.T.A ndaj gjyqtarit J.K, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 22.02.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga I.T.A ndaj gjyqtarit J.K, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

I.T.A me datë 26 Janar 2024 ka paraqitur ankesë disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj gjyqtarit J.K, me kërkesë për inicim të procedurës disiplinore. Me datë 29 Janar 2024 ankesa është dërguar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Parashtruesja e ankesës I.T.A në ankesën e paraqitur ka deklaruar se gjyqtari J.K në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.06.2023 ka aprovuar pajtimin gjyqësor të arritur në mes të propozuesit V.B të cilin e ka përfaqësuar av. I.D dhe kundër propozuesit Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilin e ka përfaqësuar I.T.A, këtu parashtruesja e ankesës. Sipas parashtrueses së ankesës, në cilësinë e përfaqësues së kundër propozuesit Qeverisë së Kosovës në procesverbalin e datës 12.06.2023 ka deklaruar se lidhur me propozimin e propozuesit për pajtim gjyqësor i propozon gjykatës që të veproj konform nenit 412, lidhur me nenin 3 pika 3.3 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, të cilat nene përcaktojnë se palët mund të zgjidhin kontestin e tyre me anë të pajtimit gjyqësor gjatë gjithë gjykimit, mirëpo gjykata sipas nenit 3 pika 3.3 nuk do ti miratojë disponimet e palëve që janë në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik. Sipas saj, këto nene e kanë obliguar gjyqtarin që në rast se propozimi për pajtim gjyqësor ka qenë në kundërshtim me ligjin, të njëjtin mos ta aprovoj. Ankuesja ndër të tjerash ka deklaruar se gjyqtari J.K e ka aprovuar pajtimin gjyqësor, mirëpo të nesërmen me datë 13.06.2023 ka telefonuar në Avokaturë Shtetërore duke

arsyetuar se vlera e përcaktuar me ekspertizë është shumë e madhe dhe qëllimi i tij dhe detyra prioritare e tij është mbrojtja e buxhetit të shtetit dhe sipas saj gjyqtari i ka ndërruar rolet këtu me të e cila ka qenë aty ligjërisht me autorizim që të mbroj financat e shtetit në bazë të Ligjit për Avokatinë dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, e që në këtë rast e njëjta ka vendosur që të hyjë në pajtim gjyqësor për të hequr rreth 400.000€ kamatë ligjore. Sipas saj, është takuar me gjyqtarin dhe i njëjti ka deklaruar se ligjërisht dhe proceduralisht është në rregull, por ka frikë nga vlera e madhe e pajtimit gjyqësor, si dhe sipas parashtrueses së ankesës nuk ka rihap seancë në rast se ka konstatuar ndonjë pa rregullsi eventuale. Ndër të tjera ka deklaruar se gjyqtari ka shkuar edhe personalisht në Avokaturën Shtetërore duke e udhëzuar udhëheqësen e parashtrueses së ankesës që të inicioj padi për anulim të pajtimit gjyqësor, me udhëzime që të thirren në gabime të lëshuara nga parashtruesja e ankesës e cila ishte përfaqësuese me autorizim, edhe pse një veprim i tillë i gjyqtarit është i ndaluar pasi që gjyqtarët nuk përfshihen në komunikim ex-parte me askënd lidhur me lëndët, pasi që propozuesi si person fizik dhe kundër propozuesi si person juridik janë palë në procedurë. Bazuar në rekomandimet e gjyqtarit, Avokatura Shtetërore me datë 06.07.2023 inicion padi për anulimin e Pajtimit gjyqësor mbi bazën e gabimeve të pretenduara dhe rekomanduara nga gjyqtari, si dhe parashtrueses së ankesës i merret lënda nga udhëheqësja e saj dhe i revokohet autorizimi. Sipas saj, me këto veprime gjyqtari i ka shkaktuar dëm jashtëzakonisht të madh pasi që me ndërhyrjen e tij tek udhëheqësit e saj për të njëjtën është iniciuar procedurë disiplinore dhe është marrë vendim për përjashtim nga shërbimi civil dhe lënda është dorëzuar në prokurori me pretendim se e kam dëmtuar buxhetin e shtetit. Andaj, ka kërkuar nga Autoriteti Kompetent që rastin ta analizoj dhe të veproj konform normave në fuqi lidhur me veprimet e gjyqtarit J.K.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se pretendimet e të njëjtës janë të paqëndrueshme dhe se nuk ka të bëjë me asnjë shkelje disiplinore sepse me rastin e lidhje së pajtimit gjyqësor e njëjta në cilësinë e përfaqësuese ka deklaruar se me këtë rast është konsultuar me kryetaren e Avokaturës së Përgjithshme Shtetërore. Parashtruesja e ankesës – përfaqësuesja e Avokaturës Shtetërore në këtë rast, nuk i ka sjellë gjykatës asnjë provë lidhur me faktin se për një ngastër që është objekt në këtë lëndë është bërë kompensimi i propozuesit, si dhe as nuk e ka kundërshtuar legjitimitetin aktiv të palës propozuesve, e që më vonë të gjitha deklaramet e saj janë kundërshtuar nga Përfaqësuesit e Organit Shpronësues të cilët në seancën e mbajtur te gjyqtari SH.B për caktimin e masës së sigurisë e kanë sjellat dokumentin sipas të cilit është kuptuar se kompensimi për një ngastër veç se ishte bërë kohë më parë. Sipas gjyqtarit është fakt se ekspertizat për vlerësimin e pronave të paluajtshme kanë pasur mospërputhje të madhe në aspektin e lartësisë së dëmit të vlerësuar dhe kjo i është bërë me dije ankueses. Ndër të tjera i njëjti ka deklaruar se nuk i ka telefonuar përfaqësuesit e Avokaturës Shtetërore dhe as nuk ka shkuar asnjëherë tek përfaqësuesit e saj, mirëpo të njëjtin kanë telefonuar që të interesohen lidhur me seancat që kanë qenë të caktuara në disa lëndë të tjera dhe njëkohësisht janë interesuar edhe për këtë lëndë, posa kanë kuptuar që është arritur pajtimi gjyqësor kanë parashtruar padi për anulimin e pajtimit gjyqësor me propozim për masë të sigurisë dhe ndaj përfaqësueses me autorizim këtu parashtrueses së ankesës I.T.A kanë iniciuar edhe procedurë penale. Sipas tij, lidhur me këtë

çështje ka dhënë edhe deklaratë në polici dhe mund të jap deklaratë edhe para Komisionit Disiplinor nëse kjo gjë do të jetë e nevojshme. Në fund ka deklaruar se çdo herë punën e tij e ka kryer në përputhje me ligjin dhe Kodin e Etikës për çka deri më tani asnjëherë nuk ka pasur asnjë vërejtje.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit J.K.

Nuk është kontestues fakti se me datë 12.06.2023 në seancën e mbajtur në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Glllogoc është arritur pajtimi gjyqësor në mes të propozuesit V.B të cilin e ka përfaqësuar av. I.D dhe kundër propozuesit Qeveria e Kosovës- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilin e ka përfaqësuar I.T.A, lidhur me patundshmërinë e shpronësuar për ndërtimin e rrugës së asfaltuar Komoran Suharekë, segmenti i 5, në vlerë prej 505.000.000€, të cilat është detyruar kundër propozuesja Qeveria e Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ti paguaj propozuesit në afat prej 60 ditësh nga arritja e këtij pajtimi gjyqësor.

Nga shkresat e lëndës shihet se trajtimi i lëndës ka nisur nga viti 2013 dhe ka kaluar tashmë nëpër disa gjyqtar, ku i fundit i ngarkuar me të ka qenë gjyqtari J.K.

Pas ngarkimit të gjyqtarit J.K me lëndën, i njëjti ka caktuar shqyrtimin kryesor i cili është mbajtur me datë 12.06.2023, ku palët kanë shprehur interesimin e lidhjes së pajtimit gjyqësor lidhur me çështjen konkrete, meqë rast edhe kundër propozuesi të cilin e ka përfaqësuar me autorizim I.T.A është pajtuar lidhur me shumën e propozuar nga propozuesi.

Gjyqtari i çështjes, nisur nga neni 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko-civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës, ka aprovuar pajtimin gjyqësor në procesverbalin e datës 12.06.2023 i cili është i nënshkruar pa vërejtje nga palët në procedurë.

Në referim të pretendimeve të parashtrueses së ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Në referim të pretendimeve të paraqitura nga parashtruesja e ankesës, në bazë të shkresave të lëndës, Kryetarja e Gjykatës nuk mundi të gjente se në rastin konkret është shkelur ligji nga gjyqtari J.K, pasi që i njëjti detyrën e tij të aprovimit të pajtimit gjyqësor e ka kryer në bazë të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili i jep të drejtën gjyqtarit të çështjes që të aprovoj a po të refuzoj propozimet e palëve për pajtim gjyqësor, gjithmonë duke pasur kujdes rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik. Në rastin konkret, gjyqtari i çështjes ka çmuar se një pajtim gjyqësor i tillë, nuk do të prekte rendin publik a po rregullat e moralit publik por as dispozitat ligjore, pasi që çështja vetëm se ishte trajtuar dy herë nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, si dhe pas marrjes së lëndës në shqyrtim nga gjyqtari J.K, kundër propozuesja në seancën përgatitore por as në shqyrtim kryesor nuk ka bërë

kundërshtime lidhur me kërkesat e propozuesit dhe si përfaqësuese me autorizim e thirrur për të mbrojtur interesin e kundër propozuesit nuk ka paraqitur asnjë propozim a po kundërshtime në lidhje me legjitimitetin e palëve në procedurë dhe as nuk kishte deklaruar a po dorëzuar ndonjë provë lidhur me ndonjë kompensim që mund të ju i ishte bërë më herët propozuesit për ndonjë ngastër kadastrale që ishte objekt kontesti.

Këto informata a po pretendime të kundër propozuesit mund të gjenden tashmë në padinë me të cilën është goditur ky pajtim gjyqësor, pretendime të cilat nuk janë bërë të njohura por as nuk janë kundërshtuar nga përfaqësuesja e kundër propozuesit në asnjë nga seancat e mbajtura lidhur me këtë çështje nga gjyqtari J.K, duke bërë kështu që gjyqtari të vihet në lajthim nga palët në procedurë. Në këto rrethana, meqenëse kundër propozuesja nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim dhe ka vendosur që të hyjë në pajtim gjyqësor, duke konsideruar se përfaqësuesi i palës është i thirrur që të mbroj interesat e palës që përfaqëson, gjyqtari i çështjes ka vendosur që të aprovoj pajtimin gjyqësor.

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit.

Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj vendimmarrjen e gjyqtarit, pasi që gjyqtari i çështjes ka kompetencë ekskluzive të vendosë në lidhje me çështjen gjyqësore me të cilën është i ngarkuar, në bazë të fakteve dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë. Ndërsa nëse palët pretendojnë se vendimi i gjyqtarit është i përfshirë në shkelje të dispozitave ligjore apo procedurale, legjislacioni në fuqi ka paraparë mekanizmat ligjor të goditjes së vendimeve me mjete të rregullta a po të jashtëzakonshme në instanca më të larta, a po në rastin konkret mundësinë e goditjes së pajtimit gjyqësor me padi.

Kryetarja e Gjykatës po ashtu nuk mundi të vërtetonte shkeljen e detyrave zyrtare të gjyqtarit ashtu siç po pretendohet nga parashtruesja e ankesës lidhur me komunikimin ex-parte të gjyqtarit me përfaqësues nga Avokatura Shtetërore a po paraqitjen e të njëjtit në zyrat e Avokaturës Shtetërore pas arritjes së pajtimit gjyqësor, me qëllim të udhëzimit të njëjtëve në paraqitje të padisë për anulim të pajtimit gjyqësor, pasi që lidhur me këtë pretendim parashtruesja nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme, ndërsa gjyqtari një gjë të tillë e ka mohuar.

Vetëm paraqitja e padisë për anulim të pajtimit gjyqësor nga zv. Avokat i Përgjithshëm i Avokaturës Shtetërore nuk mund të konsiderohet provë e cila do të vërtetonte se gjyqtari i çështjes ka bërë një udhëzim të tillë a po i ka këshilluar të njëjtit që të paraqesin këtë padi.

Ndërsa, komunikimi i informatës lidhur me epilogun e çështjes tek udhëheqësit e Avokaturës Shtetërore nuk konsiderohet shkelje a po komunikim ex-parte, kjo pasi që çështja veç se ka përfunduar dhe udhëheqësit e Avokaturës Shtetërore në çdo rast mund të kërkojnë informata lidhur me çështjet gjyqësore të cilat i përfaqësojnë si dhe kanë të drejtën e plotë që të jenë në ngjarje lidhur me lëndët të cilat marrin epilog.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se

gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/02/24, me datë 22.02.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë